REPUBLIKA E SHQIPËRISË
MINISTRIA E ARSIMIT DHE SPORTIT
DREJTORIA E PËRGJITHSHME E ARSIMIT PARAUNIVERSITAR
DREJTORIA RAJONALE E ARSIMIT PARAUNIVERSITAR
ZYRA VENDORE E ARSIMIT PARAUNIVERSITAR

Nr. 2791 Prot. Fier, më 30. 11. 2022

Lënda: Njoftim për zhvillimin e praktikës profesionale në profesionin e rregulluar të mësuesit për vitin mësimor 2022-2023.

Në zbatim të ligjit nr.69/2012, datë 21.06.2012 "Për sistemin arsimor parauniversitar në Republikën e Shqipërisë ", i ndryshuar, ligjit nr. 10171, datë 22.10.2009 "Për profesionet e rregulluara në Republikën e Shqipërisë", i ndryshuar, Udhëzim nr.30, datë 12.09.2018 _Për numrin e nxënësve për klasë dhe normat e punës mësimore në institucionet e arsimit parauniversitar", i ndryshuar, Urdhrit nr.100, datë 25.02.2022 Për miratimin e Rregullores "Për organizimin dhe zhvillimin e praktikave profesionale për profesionin e rregulluar të mësuesit", shkresës me nr.5559 prot, datë 30.08.2022 "Për zhvillimin e praktikës profesionale në profesionin e rregulluar të mësuesit për vitin mësimor 2022-2023, ZVAP Fier ju bën me dije se aplikimi për zhvillimin e praktikës profesionale për profesionin e rregulluar të mësuesisë do të kryhet nëpërmjet platformës së aplikimit online e-albania.

Kandidatët kanë të drejtë të zhvillojnë praktikën profesionale në një nga tri periudhat mësimore.

Afati i regjistrimit të kandidatëve nëpërmjet platformës e-albania që do të zhvillojnë praktikën profesionale për profesionin e rregulluar të mësuesit në periudhën e dytë mësimore është nga data **05.12.2022-15.12.2022**.

Kandidati i interesuar për zhvillimin e praktikës profesionale ngarkon në platformën online e-albania dokumentet si më poshtë:

1.
   a. Shtojca nr.5, "Formulari i aplikimit" dhe pjesë përbërëse të saj;
   b. Jetëshkrimi (cv) i praktikantit;
   c. Dokumenti i identitetit (ID);
   ç. Diplomat në fushën e mësuesisë ose diploma të njëvlershme me to, sipas përcaktimeve në ligjin nr.80 "Për arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor në institucionet e arsimit të lartë në Republikën e Shqipërisë", dhe listën e notave për secilën diplomë;
   d. Raportin mjeko-ligjor;
   e. Vetëdeklarimin e gjëndjes gjyqësore;
   f. Vërtetim nga prokuroria dhe gjykata se nuk është në procedim penal.
   g. Dokument banimi.

Adresa: Rr.Leon Rei, Fier e-mail: ZVAfier@arsimi.gov.al

CamScanner

2. Dokumentet e sipërcituara janë të detyrueshme dhe duhet të jenë të skanuara nga origjinali.

3. Kandidati i interesuar për të zhvilluar praktikën profesionale, dosja e të cilit nuk përmban dokumentet e detyrueshme për t'u ngarkuar në platformën online, sipas shtojcës nr. 5, përjashtohet nga pjesëmarrja për zhvillimin e praktikës profesionale.

4. Nëse kandidati i interesuar për të zhvilluar praktikën profesionale ngarkon në platformën e aplikimit online dokumente që dyshohet se janë të falsifikuara , përjashtohet nga pjesëmarrja për zhvillimin e praktikës profesionale. Rasti referohet në organet kompetente.

DREJTOR

Zaira Gjika

Adresa: Rr.Leon Rei, Fier e-mail: ZVAfier@arsimi.gov.al